

LIGJ
Nr.7663, datë 20.1.1993

LUFTA KUNDER PUSHTUESVE NAZIFASHISTE TE POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Statusin e invalidit të luftës e gëzojnë të plagosurit dhe të gjymtuarit, të cilët:

a) Kanë marrë pjesë në luftë me armë në dorë kundër okupatorëve nazifashistë prej datës 7 prill 1939 gjer më 9 maj 1945.

b) Kanë zhvilluar veprimtari në ilegalitet, në prapavija të armikut ose në zona të çliruara.

c) Kanë qenë të burgosur ose të internuar në kampet nazifashiste.

Qënia invalid dhe grupi përkatës vërtetohet me aktin e Komisionit të ekspertizës mjekoligjore, sipas kritereve të ligjit "Për sigurimet shoqërore".

Neni 2

Invalidi i luftës kundër pushtuesve nazifashistë, si figurë e lartë e popullit dhe e atdheut gëzon mbrojtje të veçantë ligjore.

Neni 3

Invalidët e mësipërm gëzojnë këto të drejta financiare:

a) Invalidi i mësipërm merr një shtesë mbi pensionin e invaliditetit, masa e së cilës caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Këtë shtesë invalidi i luftës e merr edhe kur del në pension pleqërie.

b) Invalidëve që nuk kanë asnjë lloj pensioni u jepet pension invaliditeti, i barabartë me pensionin mesatar të invaliditetit të punës, sipas grupit të invaliditetit që ka.

c) Në ndihmë të invalidëve të luftës të grupit të parë që ka nevojë për shërbim, caktohet një person për shpërblim. Masa e shpërblimit caktohet nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga bashkitë ose komunat.

ç) Fondet shtesë për invalidët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë përballohen nga buxheti i shtetit.

d) Në rastet e ndryshimit të pagave, pensioni i invaliditetit, së bashku me shpërblimet, pësojnë ndryshimet përkatëse.

Neni 4

Invalidët e luftës gëzojnë të drejtën e kurimit falas në spitalet dhe qendrat e ndryshme kurative që financohen nga shteti.

Barnat, sipas raporteve mjekësore jepen falas. Vlefta e tyre përballohet nga shteti.

Neni 5

Invalidët që kanë gjymtime të rënda, kanë të drejtë të diagnostikohen e kurohen në klinikat jashtë shtetit. Dërgimi për kurim bëhet me vendim të komisionit përkatës mjekësor. Invalidët e luftës pajisen me mjete ortopedike, proteza dhe mjete lëvizëse për invalidë.

Neni 6

Udhëtimi me mjetet e komunikacionit qytetar bëhet falas, kurse me mjetet e komunikacionit ndërqytetar me gjysmë bilete.

Për këtë qëllim dëshmia e invaliditetit shërben si dokument ligjor, e cila duhet të ketë firmën dhe vulën e organit drejtues të shoqatës dhe të organit financiar të vendbanimit të invalidit.

Dëshmia i jepet invalidit pavarësisht nga anëtarësia në shoqatën e invalidëve.

Neni 7

Shteti u krijon invalidëve të luftës kushte të mira për strehim.

Shpenzimet e varrimit për invalidët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë përballohen nga pushteti lokal.

Neni 8

Shoqata e invalidëve të luftës financohet nga buxheti i shtetit. Ajo gëzon përkrahjen sociale dhe materiale nga shteti.

Neni 9

Invalidët e luftës nuk paguajnë asnjë lloj takse të drejtpërdrejtë.

Neni 10

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Këshilli i Ministrave.

Neni 11

Çdo dispozite që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me deketin nr.454, datë 8.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha